

## EKSTRAKT NGA INTERVISTA

*[Intervista e gjatë e historisë gojore me narratoren u realizua më 3 maj, 2021 në Prishtinë. Me kërkesen e narratores për anonimitet, ne kemi fshehur identitetin.]*

**Narratorja:** E maj në mend ni rast e thirra në telefon, tha, u lajmëru ni mashkull, tha, “E kom banesën te hotel ‘Siriusi’, mrapa hotel ‘Siriusit’”. Po ma spjegon sa osht’ banesa e sene tha, “Dy-tri herë në javët, jo ma shumë”, “Okej, në rregull”. Po e kom pasë [qashtu], kurrë nuk kom tregu që jom nonë vetushqyse, s’kom pasë qef se pak e kom pasë ni drojë që e kanë ni respekt ma të madh nëse ti je e martume. Edhe tha, “Munesh edhe me ardhë me jetu këtu” thashë, “Jo, une jetoj me burrin tem, s’kom nevoj” thashë, “unë e kom banesën tem”. Po thashë, “Veç po du me i ndihmu burrit, me i dalë në krahë edhe me punu diçka”. “Okej”.

Edhe na okej në rregull u murrëm vesh, thashë, “Ku po takohemi?” “Po takohemi dytë në Prishtinë edhe të çoj te banesa e sheh”. Thashë, “A muj me ditë ma saktë çka kom me bo une?” “Po s’ki kush e di sa punë, qaty me fshi pak banesën, naj teshë diçka pa la” edhe tha, “Valla” tha, “une jom pak diçka smutë prej unazave të qafës” tha, “najherë duhet me m’i ngjeshë”. Thashë, “Kqyre zotni kur të hap konkurs herën tjetër, hap konkurs për fizioterapeute” thashë, “e jo pastruse”. Thashë, “Se une” thashë, “jom t’u ardhë me pastru” thashë, “e jo me të bo masazhë”.

Thashë, “Kërkoj falje po masazh veç burrit tem muj mi bo”. “Po” tha, “ti s’ki kush e di çka punë”. Thashë, “Okej de, në rregull osht’, më fal që të mora kohë, as s’po du me të marrë ma shumë kohë ty, as ti mu”. “Po” tha, “kjo shumë normale osht’”, thashë, “Zotni s’jom e interesume me vazhdu muhabetin”, thashë, “s’jom e interesume as për punë”. Edhe e kom ndërpre. Edhe mo prej aty s’kom lyp mo punë nëpër portale, se diqysh ty po të lyp mirëmbajtëse e hajt ti mu bonëm masazh të shpinës e të qafës. Edhe kur më tha ashtu meniherë e stopova.

E tani kur më gjejke najkush, për shembull kom në katun aty shumë gra që punojnë qishtu, fshijnë. Edhe ma bojke, “Valla më ka thirrë qitu njana me shku, a po shkon ti se s’po muj se jom shumë e ngarkume qat ditë?” “Ani” shkojsha. Masanej fillova me punu në pastrim kimik në Dragodan edhe aty jom konë pa kontratë. Plus më pagujshin veç niqin euro, gjashtë ditë të javës i kom pasë. Edhe aty kom punu gati ni vjet.

**Intervistuesja:** Qysh kishe llogari me punu aty?

**Narratorja:** Realisht jo pse kisha llogari, e pagujsha ni mujore, se me pagu çdo ditë s'më delke rroga. E pagujsha mujoren edhe i kisha veç katër orë punë. Masanej pjesën tjetër shkojsha fshijsha dikun, e nxirrsha. Tani masi visha në Prishtinë me shku në punë aty, deri në 12:00 isha në pune, prej 12:00-ve nëse më thirrke dikush me shku e lejsha 12:30 - 13:00, varet sa ish larg edhe shkojsha vazhdojsha, masanej hecsha në shpi. Ni kohë bajagi të gjatë më ka ndodhë qashtu deri sa dikur e lashë se ja nisi djali me nejt shumë pa mu. Po e lashë punën e pastrimit se dy herë ose tri insisitova me më regjistru, dojsha me më ecë kontributet. Edhe nuk e di pse ju kish fokusu mendja, ideja që une marrë social, e unë nuk mirrsha social.

Thashë, “Unë asniherë nuk e kom bisedu me ty këtë punën e socialit”, bile as nuk e dike që unë isha e ndame. Edhe pse kom punu dikun nuk ja kom tregu jetën personale temën, po e kom burrin edhe djalin, kaq. Edhe thashë, “Nuk e di” thashë, “pse tu ka fokusu kjo në mendje ty tash, unë s'marr social, s'jam rast social une. Pse me marrë unë social? Social” thashë, “duhet me marrë ai që s'osht në gjendje me punu, unë jom në gjendje me punu, jom e aftë për punë. Kush të ka thonë që marrë social?” “Jo, s'di pse më doket që qashtu”, “Jo nuk e di çka po të doket. A ka mundësi me më regjistru?” Dy-tri herë prapë veç arsyetimin e njejtë deri sa e pashë. U konë tetori kur e kom lonë, në fund tetorit. Në fillim tetorit, i pari, dyti, i kom thonë që, “Dej në fund të mujit jom këtu, kështu që je i lirë me gjetë dikun tjetër gjatë kësaj periudhës. Une mo po shkoj”.